

# INTERVISTE: ANILA RUBIKU

Posted by Parrulla July 11, 2015



Të ftohtin e dimrit, që ishte brenda shtëpive të paizoluara, më tepër sesa jashtë tyre dhe banja e parë në det, te hekurudhat, gjatë verës, i kujtohen ende dhe sot vajzës durrsake, sepse i shërbyen si detaje për të krijuar një botë imagjinare të vetën. Ajo është artistja e arteve pamore, Anila Rubiku, e cila u largua nga Shqipëria me dëshirën për të qenë e pavarur. Gjatë një bisede me të, rrëfen se i sheh vitet e rinisë, si vite që nuk do t'i rikthehen më pas. Artistja mendon se, asokohe, e ardhmja e një individi ishte e planifikuar, askush nuk kishte mundësi tjetër jetese, veçse të ëndërronte.

Emri i saj ishte shënuar dy herë me rreth të kuq dhe nuk kishte mundësi që të niste Akademinë e Arteve, për shkak të biografisë së saj familjare. Më pas, në Shqipëri ndodhën disa ndryshime politike, të cilat i dhanë një tjetër rrjedhë jetës së saj, pavarësisht vështirësive që vazhdonin ende. Pasi arriti të mbarojë vitin e tretë në Akademinë e Arteve, nisi të mendonte nëse ishte e interesuar për ndryshimet politike që po ndodhnin në Shqipëri, apo kishte dëshirë që të studionte jashtë vendit?

Ajo na tregon se i interesonte të jetonte jetën e saj, si femër dhe artiste. Kështu u hap një derë e re, për artisten shqiptare, e cila pati dëshirën që të informohej mbi kulturën bashkëkohore, të formohej si njeri, të tregonte se çfarë dinte të bënte dhe të mos gjykohej më për biografinë familjare. Në vitin 1994 mori vendimin për t'u larguar jashtë vendit, për studime, në Akademinë e Brera- s në Milano. Pavarësisht sukseseve që numëron, sikundër janë: të qenët një nga 100 mendimtarët globalë, shpallur nga revista "Foreign Policy" (2014), për idetë edhe punën e bërë, ftesa që pati nga "Human Rights Foundation" në Oslo etj., për të ka rëndësi vetëm e sotmja dhe e ardhmja.

**Cfarë kujtimesh ruani nga fëmijëria juaj në qytetin bregdetar, në Durrës?**

Dimri në Durrës nuk ishte shumë i ftohtë, por shtëpitë ishin të paizoluara dhe brenda në shtëpi ishte më ftohtë sesa jashtë. Kujtimet janë pozitive. Kujtoj me mall ato ditë të fillimit të verës, kur durrsakët bënin banjën e parë në det te hekurudhat. Për një durrsak banja e parë ishte me të vërtetë stina e verës. Kujtoj me mall këngën e gjinkallave të plepat, në muajin korrik dhe gusht, gjumin që bënim pas drekës, sidomos ditët e diela nën hijen e plepave. Kujtoj me mall shalqirin që pritej në atë vapë e zheg, parfumin e specave me gjizë, na dukej sikur kishim të gjithë botën e s'na mungonte asgjë. Kujtoj me mall parfumin e frutave, të perimeve të patrajtuara dhe erën e Adriatikut të pastër. Kujtoj një qytet me tradita të pastër. Durrsakët ishin njerëz kuriozë, që shpesh niseshin me anije të mëdha nga porti detar dhe kur ktheheshin tregonin historitë sesi jetonin të tjerët jashtë shtetit. Ishte me të vërtetë shumë interesante, sa për të shkruar një libër, jo historitë që ata tregonin, por mënyra se si në kalamajtë dëgjonim historitë e tregimet prapa derës për atë botën jashtë shtetit. E mbi të ndërtonim një botë tjetër imagjinare, që ishte e jona.

**Për shkak të sistemit komunist vështirësitë kanë qenë të mëdha. Ç'mund të thoni për rininë, kohëkur keni jetuar në një vend totalitar, në një shoqëri të sunduar nga demagogjia?**

Çdo kohë ka anët pozitive dhe negative. Sot dua të shikoj anët pozitive të atyre viteve, vitet e rinisë nuk kthehen më. Ndër gjërat më të vështira për mua në ato vite ishte të mendoje që nuk kishte tjetër mundësi jetese, përveçse asaj që kishim. Ideja që gjithçka për ty si individ ishte e planifikuar, edhe pse nuk kishte mundësi tjetër jetese, veçse të ëndërroje. Demagogjia s'ka ndryshuar shumë në këtë aspekt, ekziston edhe sot, sidomos ajo politike. Por, të rinjtë, sot, në Shqipëri kanë mundësitë, nëse me të vërtetë duan të kenë një të ardhme në jetë, mund të zgjedhin, si dhe të ëndërrojnë goxha. Kjo është një gjë shumë e rëndësishme, kush pushon se ëndërruari, pushon së jetuari. Në jetë duhet të ëndërrosh e të kesh ëndrra të mëdha, që të paktën një pjesë të tyre t'i realizosh.

**Vëmendja juaj fokusohet drejt artit. Si ju lindi dëshira, që të studioni në Akademinë e Arteve në Tiranë?**

Kur unë mbarova liceun artistik në Durrës ishte akoma diktaturë. Bëra konkursin për të hyrë në Akademinë e Arteve, dy herë me radhë. Në atë kohë bëhej konkurs për të hyrë në akademi dhe ishte me numër të kufizuar. Herën e parë nuk fitova po kështu edhe të dytën. Situata politike në Shqipëri ndryshoi me Ramiz Alinë. Konkurova, më në fund fitova, herën e tretë. Kështu që, fillova vitin e parë të Akademisë së Arteve. Disa vite më vonë, pasi kisha filluar akademinë, më thanë se emri im vitin e parë dhe të dytë, kur bëra konkursin, ishte shënuar me rreth të kuq, që kur lista vinte në akademi. Kështu që, nuk kisha shanse në të vërtetë prej biografisë sime familjare. Në vitin e dytë të akademisë filluan të gjitha ndryshimet politike, si dhe lëvizjet studentore. Akademia, si të gjitha shkollat dhe universitetet në Shqipëri, kishte probleme. Unë mbarova dhe vitin e tretë. Situata në Tiranë e në Shqipëri ishte e vështirë, si nga ana akademike dhe nga ajo politike. I bëra pyetjen vetes, nëse isha e interesuar për ndryshimet politike që po ndodhnin në Shqipëri në atë kohë? Apo isha më e interesuar të edukoja veten e të studioja jashtë vendit?

**Kisha nevojë për më tepër hapësira artistike**

Pjekuria artistike për Anila Rubikun do të vinte vetëm pasi të niste edhe njëherë studimet e larta, por kësaj here jashtë vendit, në Milano, Itali. Ajo na tregon sesi arriti të informohej në të gjitha fushat, duke jetuar larg zhurmës politike të kohës.

**Më vonë vazhduat sërish studimet e larta në Akademinë e Brera-s në Milano. Për të provuar një traditë të artit bashkëkohor, që në Shqipëri nuk e kishit zbuluar ende? A mund të na tregoni sesi u**

Përgjigjja që i dhashë vetes ishte: Më interesonte të jetoja jetën time, si femër dhe artiste. Të shikoja dhe të rritesha, si person, si një femër e lirë dhe e pavarur. Të lexoja, të informohesha mbi kulturën bashkëkohore, në të gjitha fushat, sepse e dija që isha mbrapa. Të formohesha si njeri, të isha e zonja për çka dëshiroja të bëja, të mos gjykohej nga ambienti për biografinë familjare. Pasi mora vendimin, në vitin 1994, bëra provimin për të hyrë në Akademinë e Brera-s në Milano. E fitova qysh herën e parë. Arsyeja që zgjodha Brera-n është se disa nga artistët e rrymës së “arte povera” jepnin mësim në këtë akademi. Vite që për mua kanë qenë shumë edukative dhe interesante, si nga ana personale, edhe nga pjekuria artistike.

**Tashmë jo vetëm pjesë e artit bashkëkohor ndërkombëtar, por revista “Foreign Policy” ju renditi një ndër 100 gratë më mendimtare të botës. Si ndiheni për këtë ?**

Revista “Foreign Policy” (2014) më zgjodhi si një nga 100 mendimtarët globalë, në këtë rast s’ka rëndësi gjinia, por idetë dhe puna e bërë. Ndihem shumë e kënaqur, por kjo bën pjesë në të kaluarën. Në muajin maj 2015 isha e ftuar nga “Human Rights Foundation” në Oslo për të njëjtën arsye, idetë dhe punën e bërë, por dhe kjo tashmë është pjesë e së shkuarës. Për mua, rëndësi ka e sotmja dhe e ardhmja.

**Gruaja në Shqipëri duhet të ketë vendin që meriton**

Edhe pse prej 21 vitesh jeton larg, vazhdon që të jetë e interesuar për situatën e gruas në Shqipëri, duke i qëndruar mendimit se jemi ende një vend, që femrës duhet t’i japim vendin që meriton, nga ligji dhe nga organet shtetërore. Aktualisht është pjesëmarrëse në Bienalen e Artit Bashkëkohor, edicioni i pestë, në Selanik, që zgjat deri më 30 shtator 2015.

**Keni realizuar një projekt në burgun e grave, por a e shikoni Shqipërinë, si vendin e kontrasteve të mëdha, nga mënyra e jetesës dhe emancipimit, veçanërisht atij femëror?**

Isha dhe jam e interesuar mbi situatën e gruas në Shqipëri. Një vend që ka nevojë t’i japë gruas vendin që meriton në shoqëri. Të mbrohet nga ligji dhe nga organet shtetërore. Në një sistem juridik shqiptar të drejtë e të mirë, por kur korrupsioni triumfon ligji mbetet vetëm mbi një copë letër. Korrupsioni në Shqipëri është në çdo fushë, tashmë pjesë e kulturës kombëtare. Unë gjithmonë shpresoj se investimi në të drejtën dhe në një shoqëri të emancipuar ekziston kur gruaja ka vendin e duhur në drejtimin dhe në rritjen e një kombi.

**Në Shqipëri jeni prezantuar dy herë me projekte, në Bienalen e Tiranës, (2009) dhe me projektin e realizuar në burgun e grave. A keni në plan që të riktheheni sërish me ndonjë projekt në vazhdim?**

Jam duke bërë një projekt të ri mbi Durrësin dhe do të më pëlqente shumë ta prezantoja, së pari atje. Është e rëndësishme që ky projekt të shikohet nga durrsakët, sepse për të kam 2 vjet që po punoj, por meqë nuk është përfunduar nuk mund të them më tepër. Sapo ta mbaroj ndoshta do të kem mundësinë për t’u rikthyer në Shqipëri e në Durrës.

**Çështjet gjinore, arkitektura, kujtimet dhe historia zënë vendin kryesor në projektet tuaja, për të kombinuar traditën, artin dhe historinë në perspektivat bashkëkohore. Çfarë traditash shqiptare ruani ende, edhe pse jeni larg vendit, si vijnë ato të ndërthurura në mënyrë bashkëkohore?**

Të gjitha janë bashkë, si pjesë e jetës, por edhe e krijimtarisë sime.

**“Portrete provokuese”, është titulli i punëve që jeni duke prezantuar në Bienalen V në Selanik. Në pamundësi për t’i parë nga afër si do t’ia prezantonit lexuesit tonë ato?**

Flasim për lexuesin shqiptar, edhe nëse mendohet për portrete provokuese, në Shqipëri ka kudo. Portretet e grave shqiptare nën dhunën e mashkullit janë provokuese. Besoj se titulli “Shqipëria, gratë edhe ligji” thotë gjithçka e nuk ka nevojë për komente. Por për lexuesin që ka nevojë të ketë një imazh të projektit në Bienalen e Selankut, mund të shikojë fotot e punëve në websiten: <http://www.anilarubiku.com> (<http://www.anilarubiku.com>).

**Sikurse është thënë, duket sikur krijimtaria juaj i ka rrënjët në botën sociale. Dëshira juaj është që t’i bëni njerëzit më të vetëdijshëm për botën përreth, të kaluarën dhe të ardhmen e tyre. Por, te ju, në formimin tuaj, cilët janë ata artistë dhe ato ngjarje që kanë ndikuar? Modele shqiptarë apo të huaj?**

Një ndër modelet e mira për formimin tim është jeta dhe mënyra sesi e jetoj atë.

**Dhe së fundmi, cili është projekti i radhës për Anilën?**

Projekti i fundit është mbi Durrësin dhe Los Angeles-in.

### Biografia

Anila Rubiku (1970) është diplomuar në Akademinë e Arteve në Tiranë (1995) dhe të Brera-s, Milano (2000). Jetën dhe aktivitetin e saj artistik e ndan mes Torontos, Milanos dhe Tiranës. Puna e saj përfshin vizatime dhe instalacione. Ajo ka zhvilluar një mënyrë unike për të përfshirë në mënyrë aktive njerëz vendas në projektet e komunitetit, që kombinojnë traditën dhe artin, historinë vendase me një perspektivë më bashkëkohore, duke krijuar një hibrid të ri. Në Bienalen e pestë të Selanikut paraqitet me “Defiant Portraits” (Portrete provokuese). Rrënjët e krijimtarisë së Rubikut gjenden në botët sociale. Është një lloj arti që i bën njerëzit të vetëdijshëm për botën rreth tyre, të kaluarën, të tashmen dhe të ardhmen. Arti i saj është rreth jetës, siç jetohej. Ka qenë pjesëmarrëse në Pavijonin Shqiptar të Bienales së Artit në Venecia, në vitin 2011 dhe ka një aktivitet artistik të pasur me ekspozita në Angli, SHBA, Izrael, Zvicër, Ukrainë etj.

*Intervistoi: Valeria Dedaj*

*11 Korrik 2015*

<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=284148> (<http://www.shekulli.com.al/p.php?id=284148>)

**Posted in:** Uncategorized **Tagged:** Anila Rubiku, Art Pamor, Interviste [Permalink](#) [Leave a comment](#)

Blog at WordPress.com.